

Titulli i lëndës: Arkitektura moderne dhe trendet bashkëkohore

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitektures
Titulli i lëndës:	Arkitektura moderne dhe trendet bashkëkohore
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III-te (Sem-5)
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	3
Koha / Vendi:	Sipas orarit të shpallur
Mësimdhënësi:	Prof.Asoc.Dr. Teuta Jashari-Kajtazi
Të dhënat kontaktuese:	teuta.kajtazi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda përmban llojllojshmërinë dhe karakterin pluralist të zhvillimit të arkitekturës prej fillimit të shekullit 20 (1900) e deri tek ajo e kohës sonë, marrëdhëniet në mes të qenies njerëzore dhe prodhimit hapësinor modern dhe bashkëkohor
Qëllimet e lëndës:	Përmes prerjeve të ndryshme tipologjike, lëvizjeve, masave, teksteve dhe traktateve, personaliteteve dhe tërësive të arkitekturës i ofron studentit njohjen e tërë shtresimit të teorisë dhe praktikës arkitektonike gjatë shekullit 20 dhe në ditët e sotme, me çfarë punën dhe përpjekjen e tij e bën me komplekse dhe më të pasur

Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Njohuri mbi rrethanat shoqërore, ekonomike e tjera, të cilat ndikuan dhe ndikojnë në lindjen dhe zhvillimin e arkitekturës në shtetet e ndryshme evropiane dhe botërore, ndikimet reciproke në arkitekturë, veprimtarinë e arkitektëve të mëdhenj të cilët përfaqësojnë lëvizjet në arkitekturën e epokave të mëdha artistike, si në vazhdim:</p> <p>Shkolla e Chicago-s, Lëvizjet kthesë në Art dhe Arkitekturë, Arkitektura Organike dhe Frank Lloyd Wright, Walter Gropius dhe Bauhaus, Le Corbusier, Mies Van Der Rohe, Alvar Alto, Metabolizmi Japonez, Robert Venturi, Modernizmi, Norman Foster, Renzo Piano, Richard Rogers, Qyteti Postmodern: Richard Meyer, Michael Graves, Rob Krier, Frank O. Gehry si dhe Trendet/ zhvillimet aktuale në Arkitekturë. Në kontekst të veçant do të përmenden zhvillimet më të rëndësishme në Arkitekturën moderne në Kosovë.</p>
--	--

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	1	10	10
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	6	3
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	6	6
Detyrë shtëpie	1	6	6

Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	4	4
Përgatitja për provimin final	1	6	6
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			
Projektet, prezantimet, etj.	1	10	10
Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë...			

Total			75
Metodat e mësimdhënies:			
Metodat e vlerësimit:	Ligjërata tematike, analiza e shembujve praktik nëpërmes projeksioneve vizuale Ushtrimet: Seminar me tema të arkitekturës bashkëkohore, gjegjësisht, prej vitit 1900 e deri në ditët e sotme. Konsultimet		
	Detyra semestrare / Ese/ seminari/prezentimi 50% Vijimi i rregullt 10% Testet semestrare (2) 40% (apo provimi) Totali 100%		
Literatura primare:			
	<p><i>T. Jashari-Kajtazi</i>: Ligjëratat në trajtë dispense/ me prezantime të bashkangjitura (ne forme elektronike)</p> <p><i>T.Jashari-Kajtazi, A.Jakupi</i>: Interpretation of architectural identity through landmark architecture: The case of Prishtina, Kosovo from the 1970s to the 1980s, <i>Frontiers of Architectural research</i>. https://teutajasharikajtazi.wordpress.com</p> <p><i>T.Jashari-Kajtazi</i>: Architectural interpretation of the National and University Library in Prishtina; the influence in its surroundings, <i>International Journal for Engineering and Information Sciences</i>, Pollack periodica. https://teutajasharikajtazi.wordpress.com</p> <p><i>William J. Curtis</i>: <i>Modern Architecture since 1900</i>, 1996 <i>Gosset, Leuthause</i>: <i>Architecture in the twentieth Century</i>, 2005 <i>Le Corbusier</i>: <i>Drejt një arkitekture</i>, 2013</p> <p><i>Luca Molinari</i>: <i>Architecture Movements and Trends from the 19th Century to the Present</i>, 2015</p>		
Literatura shtesë:	<p><i>M. Moffett, M. Fazio, L. Wodenhause</i>: <i>A World History of Architecture</i>, 2003</p> <p><i>Xhambazi, A.</i> (2016). <i>Transformation of Theory and Practice: Shaping Strategies of Contemporary Architecture</i>. <i>International Journal of Contemporary Architecture "The New ARCH"</i>, 3(1), 25-38. http://the-new-arch.net/Articles/v03n01a04----Arta-Xhambazi.pdf</p>		
Hartimi i planit mësimor			
Java	Titulli i ligjëratisë		
Java 1:	HYRJE NE ARKITEKTUREN MODERNE		

Java 2:	EPOKA E MAKINAVE Makinat për të punuar në to Rrokaqielli si simbol i kohes Frank Lloyd Wright
Java 3:	EPOKA E MAKINAVE Arts and Crafts
	Art Nouveau dhe Secesioni Antoni Gaudi
Java 4:	BOTA E RE E GUXIMSHME Bauhaus Banimi Masiv Evropian
Java 5:	BOTA E RE E GUXIMSHME Ludwig Mies Van Der Rohe Le Corbusier
Java 6:	Testi-1 (dhe ushtrimet e rregullta)
Java 7:	Alvar Alto dhe zhvillimet në Skandinavi Kenzo Tange – Metabolizmi Japonez si dhe zhvillimet në Japoni
Java 8:	<i>Prezentimi i draftit të parë të punimit semestral</i>
Java 9:	Qyteti postmodern Robert Charles Venturi
Java 10:	Arkitektura në kontekst të perspektivave bashkohore
Java 11:	Strukturat e Hapura dhe Arkitektura për Artin
Java 12:	Eko Arkitektura dhe dizajni i qëndrueshem
Java 13:	Profesioni i arkitektit dhe shoqëria (Alejandro Arravena, Shigeru Ban...)
Java 14:	Testi-2 (dhe ushtrimet e rregullta)
Java 15:	<i>Prezentimi i draftit final të punimit semestral</i> <i>Pas prezentimit, po të njëjten ditë seminarët dorëzohen në formë elektronike deri në orën 24:00 (24.12.2025)</i>
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.